



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.518/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 35 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet lista e lëndëve të dorëzuara nga Gjykata e Apelit për transfer në Gjykatën Komerciale.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 20 dhjetor 2022, nga kryetari i Gjykatës së Apelit ka pranuar listën me lëndë që do të kalojnë në Gjykatën Komerciale nga Gjykata e Apelit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës pas shqyrtimit të listës së lëndëve që do të kalojnë në Gjykatën Komerciale nga Gjykata e Apelit, konstatoj se lista parashihet 398 lëndë të kalojnë në Gjykatën Komerciale. Po ashtu, KGJK vlerëson se pas përfundimit të këtij procesi Gjykata Komerciale duhet të fillojë trajtimin dhe shqyrtimin e këtyre lëndëve që bien në juridiksionin e saj.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Gjykatës Komerciale;
- Gjykatës së Apelit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.

